



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

implemented by:  
**inter  
cooperation**

Natural Resource Management  
Rural Economy  
Local Governance and Civil Society

Swiss – Kosovo

Local Governance and Decentralization Support

LOGOS



Prezentim i buxhetit komunal për vitin 2011

# Komuna e NOVOBERDES

LOGOS



Ky prezentim është përgaditur nga RECURA Financials  
për projektin LOGOS të implementuar nga Intercooperation

**Maj 2011**

RECURA Financials

Address: Nëna Terezë 28/1, 10000 Prishtina, Kosovo

tel: +381 (0)38 777 800, Fax: +381 (0) 38 22 14 14 ; cel: +386(0)49 160 049; 777 800

info@recura.biz - www.recura.biz

# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL .....	4
ZYRA E KRYETARIT .....	7
ASAMBLEJA KOMUNALE.....	7
ADMINISTRATA DHE PERSONELI KOMUNAL .....	9
SHËRBIMET PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMEREGJNCA .....	9
BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL.....	11
KADASTRA E PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI.....	11
SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE.....	13
ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI .....	13
INVESTIMET KAPITALE .....	15

## HYRJE

Ky dokument është një përmbledhje e buxhetit komunal për vitin 2011, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ky dokument nuk është dokument zyrtar komunal dhe paraqet një përmbledhje të buxhetit të përgaditur nga projekti LOGOS me qëllim të informimit sa më të mirë dhe përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve në procesin buxhetor në komunë.

Dokumenti përmban një kategorizim të buxhetit sipas drejtorive dhe kategorive të shpenzimeve si dhe listën e projekteve të investimeve kapitale të planifikuara nga komuna për vitin 2011.

## PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL

Novoberde - 654	
PASQYRE E PËRGJITHSHME E BUXHETIT	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>2,150,328.00</b>
<b>INVESTIMET KAPITALE</b>	<b>522,653.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	<b>1,403,896.00</b>
Pagat - Administrata Komunale	372,767.00
Pagat Arsimi	855,917.00
Pagat Shendetesia	175,212.00
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	<b>157,333.00</b>
Administrata Komunale	54,351.00
Arsimi	89,951.00
Shendetesia	13,031.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	<b>30,348.00</b>
Administrata Komunale	11,254.00
Arsimi	14,500.00
Shendetesia	4,594.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	<b>36,098.00</b>
Administrata Komunale	17,000.00
Arsimi	13,000.00
Shendetesia	6,098.00



Për vitin 2011, komuna e Novobërdës është planifikuar të ketë në dispozicion 2,150,328 Euro, nga të cilat Qeveria ka ndarë 2,121,265 Euro, ndërsa komuna planifikon të realizojë të hyra vetanake në vlerë prej 29,063 Euro.

Siç mund të shihet nga tabela përmbljedhëse, nga ky buxhet, 522,653 Euro janë ndarë për projekte të investimeve kapitale në komunën e Novobërdës.

Pagat dhe mëditjet e planifikuara kapin vlerën prej 1,403,896 Euro, nga të cilat shpenuesi më i madh është sektori i arsimit dhe kulturës e rinisë me 855,917 Euro, derisa administrata komunale ka të buxhetuara 372,767 Euro ndërsa shëndetësia 175,212 Euro për paga. Pagat dhe mëditjet janë të llogaritura në vlerë bruto përfshi edhe të gjitha tatimet dhe kontributet.

Shpenuesi i tretë buxhetor për nga madhësia është kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ku për komunën e Novobërdës janë planifikuar 157,333 Euro, ku shpenzuesit më të mëdhenj janë administrata dhe sektori i arsimit.

Shërbimet komunale kapin vlerën prej 30,348 Euro, nga të cilat gati 85% janë të dedikuara për administratën komunale dhe për sistemin arsimor.

Subvencionet dhe transferet janë në nivel prej 36,098 Euro, nga të cilat administrata komunale paraqet shpenuesin më të madh buxhetor në këtë kategori.



## ZYRA E KRYETARIT

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
ZYRA E KRYETARIT	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>45,297.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	<b>35,093.00</b>
Numri i stafit	7
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	<b>7,204.00</b>
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	<b>0.00</b>
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	<b>3,000.00</b>

Nga zyra e Kryetarit të Komunës paraqiten shifrat prej 45,297 Euro, të cilat shfrytëzohen për të paguar stafin dhe mëditjet e Zyres, që në vitin 2011 planifikohet të jenë gjithsej 7 vetë, me një pagë mesatare mujore (përfshi mëditjet) prej 417.8 Euro. Zyra e kryetarit ka të buxhetuara 7,204 Euro për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

## ASAMBLEJA KOMUNALE

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
ASAMBLEJA KOMUNALE	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>54,454.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	<b>49,454.00</b>
Numri i Anetareve dhe Stafit	
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	<b>3,000.00</b>
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	<b>0.00</b>
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	<b>2,000.00</b>

Asambleja e Komunës së Novobërdës poashtu ka një shpenzim shumë të koncentruar dhe atë shumicën në paga dhe mëditje për asambleistët në vlerë prej 49,454 Euro.





## ADMINISTRATA DHE PERSONELI KOMUNAL

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
<b>ADMINISTRATA (Administrata dhe Personeli, Buxheti dhe Financat, Zyra e komuniteteve)</b>	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>208,509.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	171,108.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	54
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	26,147.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	11,254.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	0.00

Në këtë linjë buxhetore janë të përfshirë drejtoritë e administratës dhe personelit, buxhetit dhe financave, Zhvillimit Ekonomik, zyra e komuniteteve si dhe inspekcioni komunal, me gjithësej 54 të punësuar. Buxheti total për shpenzimet e administratës komunale është 208,509 Euro, nga të cilat 171,108 Euro janë të dedikuara për paga dhe mëditje, me një pagë mesatare mujore prej 264 Eurosh. Mallrat dhe shërbimet janë të llogaritura në vlerë prej 26,147 Eurosh.

SHËRBIMET PUBLIKE,  
MBROJTJA CIVILE DHE EMEREGJNCA

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
<b>Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca</b>	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>60,831.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	50,831.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	13
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	8,000.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	0.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	2,000.00

Shërbimet e përgjithshme publike dhe emergjencat kanë një buxhet prej 60,831 Eurosh, prej të cilave shumica janë të dedikuara për paga dhe mëditje, 50,831 Euro. Me një staf prej 13 vetësh, paga mesatare mujore për këtë drejtori është 325.8 Euro.



## BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>46,912.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	31,912.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	10
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	5,000.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	0.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	10,000.00

Drejtorja për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural ka një staf prej 10 vetësh dhe një buxhet vjetor prej 46,912 Euro. Paga mesatare që marrin shërbyesit civil në këtë drejtori (përfshi mëditjet) është 265.94 Euro për muaj. Një shumë e vogël është e dedikuar për mallra dhe shërbime në vlerë prej 5,000 Euro derisa subvencionet dhe transferet janë buxhetuar me 10,000 Euro.

## KADASTRA E PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>39,369.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	34,369.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	9
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	5,000.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	0.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	0.00

Drejtorja e Kadastrës si dhe ajo e Planifikimit urban dhe e mjedisit punëson një staf prej 9 vetësh me pagë mesatare prej 318.23 Euro dhe me një buxhet total vjetor prej 39,369 Euro.



## SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
Shendetesia dhe Mireqenia Sociale	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>238,935.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	175,212.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	46
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	13,031.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	4,594.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	6,098.00
<b>SHPENZIMET KAPITALE</b>	40,000.00

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale është njëra nga dy kategoritë specifike buxhetore, të cilat marrin grant (buxhet) të posaçshëm nga qeveria dhe poashtu është një nga drejtoritë me buxhet më të lartë. Për vitin 2011 për shëndetësi dhe mirëqenie social janë ndarë 238,935 Euro. Nga këto 175,212 Euro janë të ndara për paga dhe mëditje për punëtorët e këtij sektori (46 sish), të cilët marrin një pagë mesatare prej 317,41 Euro për muaj. Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime është për vitin 2011 kap vlerën prej 13,031 Euro. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale poashtu kanë një karakteristikë se investimet kapitale janë kategori e veçantë këtu, ku për vitin 2011 janë ndarë 40,000 Euro për investime direkte kapitale në këtë sektor dhe ate për ndërtimin e një kati të ambulancës në fshatin Kuvçë.

## ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI

KOMUNA:	TOTAL
Novoberde - 654	
Arsimi	
Viti 2011	
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>1,033,368.00</b>
<b>PAGAT DHE MEDITJET</b>	855,917.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	200
<b>MALLRA DHE SHERBIME</b>	89,951.00
<b>SHERBIMET KOMUNALE</b>	14,500.00
<b>SUBVENCIONET DHE TRANSFERET</b>	13,000.00
<b>SHPENZIMET KAPITALE</b>	60,000.00

Sektori i arsimit dhe kulturës është shpenzuesi më i madh buxhetor në komunën e Novobërdës me një buxhet të planifikuar prej 1,033,368 Eurosh. Nga këto, 855,917 Euro janë të ndara për paga dhe mëditje për 200 punëtorët e arsimit dhe kulturës, me një pagë mesatare mujore prej 356.63 Euro. Shpenimet kapitale të parapara për këtë sektor në vitin 2011 kapin vlerën e vogël prej 60,000 Euro dhe do të investohen për ndërtimin e një objekti shkolle dhe ambulante në Bolevc si dhe për rregullimin e bodrumit të shkollës dhe përshtatjen për kabinet të informatikës në Llabjan. Mallrat dhe shërbimet janë poashtu shpenzues i madh me një vlerë prej 89,951 Euro. Për shërbimet komunale janë ndarë 14,500 Euro, derisa për subvencione dhe transfere 13,000 Euro.



## INVESTIMET KAPITALE

Këtu përfshihen të gjitha investimet kapitale të planifikuara nga komuna e Novobërdës, me përjashtim të investimeve kapitale në shëndetësi dhe arsim, të cilat janë të llogaritura në kuadër të këtyre dy sektorëve. Totali i planifikuar i investimeve kapitale (me përjashtim të shëndetësisë dhe arsimit) për vitin 2011 është 412,653 Euro, të planifikuara për realizimin e 7 projekteve në kuadër të komunës, të paraqitura në tabelën më poshtë.

Është me rëndësi të theksohet se projektet kapitale, sikurse i gjithë buxheti, i nënshtrohen një rishikimi në gjysmë të vitit dhe mund të pësojnë ndryshime. Ky proces i revidimit është shumë i rëndësishëm dhe pjesëmarrja e qytetarëve është shumë e rëndësishme.

	<b>KOMUNA:</b>	<b>TOTAL</b>
	<b>Novoberde - 654</b>	
	<b>Arsimi</b>	
	<b>Viti 2011</b>	
	<b>SHPENZIMET KAPITALE TOTALE (PA ARSIMIN DHE SHENDETESINE)</b>	<b>412,653.00</b>
1	<b>Participim në projekte</b>	42,653
2	<b>Renovimi I ujesjellsit kolonia e re- Mehmetaj-Pllavicë</b>	105,000
3	<b>Asfaltimi I rruges Llabjan-Baqevisht</b>	120,000
4	<b>Asfaltimi I rruges Strazhë-Kishë</b>	45,000
5	<b>Ndertimi I rruges Kisha e saseve-Kala</b>	40,000
6	<b>Asfaltimi I rruges ne Koretisht</b>	40,000
7	<b>Asfaltimi I rruges shtepia e shendetit-Novoberde</b>	20,000

# LOGOS

